

familjarët e kanë varrosur Ilinë në Leshqe [Beograd], pranë të afërmit Goranit [të shikohet regjistrimi në faqën 214]. Miladini u varros në varrezat e fshatit Shushure më 3.10.1998, ndërkaq Miroslavi në varrezat e fshatit Tërnavë e Epërme.

Burimet: FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, XXI, 58-59; deklarata A.P. FDH-30628; deklarata L.R, FDH-6643; deklarata V.G, FDH-14970; deklarata L.J., FDH-19662; deklarata I.P, FDH-24475; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 17, 51, 34, 21, 57, 50; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; M. Sekulić, *Beograd...*, 69 i 78; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.P01440, FDH-33047.

Muharrem (Qazim) Damjani

(14.09.1955, rom nga Gjakova/Đakovica, taksist, gjasthtë fëmijë)

Muharremi me familje jetonin në Rrugën *Ismet Sariqka* numër 31 në Gjakovë/Đakovica. Në datën 29.09.1998, ai me taksin e tij [*Mercedes, karavan i bardhë*] e ka çuar shqiptaren Raze Arifajn me të bijën dhe mbesën në fshatin **Kralan/Kraljane**. Me vajzën e Razes ai u dakordua që të kthehej ditën tjetër për t'i kthyer në qytet. Të nesërmen, më **30.09.1998**, nga ora 11:00, Muharremi u nis për në Kralan/Kraljane, së bashku me Tahirin, bashkëshortin e Razes. Në hyrje të fshatit, dëgjuan një të shtënë. Pastaj, u dolën përpara dy burra, të cilët ishin të veshur me uniforma që i kishin stemat e UÇK-së, dhe një tjetër i veshur vetëm me rroba civile. Të gjithë ishin të armatosur. Kërkuan që Muharremi tu dorëzonte makinën. Ai i luste që mos ta bënin këtë, sepse falë makinës ai e mbante tërë familjen. Përkundër lutjeve, ata hyrën në makinë dhe i urdhëruan Muharremit që t'i çonte atje ku ishte nisur paraprakisht. Kur arritën, vajza e Razes filloi të vajtonte me zë kur vuri re se kush ishte në veturë me të atin dhe shoferin. Atëherë, pjesëtarët e UÇK-së e liruan Tahirin dhe me Muharremin dhe makinën e tij u nisën në drejtim të panjohur. Nga ajo ditë, Muharremi i është humbur çdo gjurmë. Zhdukjen e tij e ka evidentuar KNKK-ja dhe në listën e të zhdukurve lënda e tij e mban numrin rendor YUK-050100-01.

Burimet: deklarata Z.D, FDH-18935; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Milan (Jovan) Bundalo

(25.11.1950, serb nga Vranja, dy fëmijë, pjesëtar i UJ-së)

Milani e ka mbaruar shkollën për nënoficer këmbësorie në Sarajevë [BdheH]. Me bashkëshorten Blagicen dhe djemtë Sinišen dhe Simën jetonin në Vranjë. Në fillim të verës së vitit 1998, e dislokuan në postbllokun kufitar **Morinë/Morina**. Pas tre muajsh, u shpërblye me pushim dhe shkuarje në shtëpi për disa ditë. Më pas sërish, më 28.09.1998, u kthye në detyrë. Dy ditë më vonë, më **30.09.1998**, në mëngjes, u nis me disa ushtarë me kamion për në Gjakovë/Đakovica, që të ngarkonin racione ushqimi për njësitin e vet. Ishte i ulur pranë ngasësit. Gjatë rrugës, jo larg postbllokut kufitar ushtarak *Maja Čoban*, kamioni ra mbi një e pastaj në minën tjetër. Milani u plagos rëndë nga eksplozimet që pasuan, ndërkaq ushtarë të tjerë vetëm lehtë. Ka dhënë shpirt pas disa minutash. Një ditë më vonë, u varros në Varrezat e Bunushevaçit në Vranjë.

Burimet: deklarata B.B, FDH-25480; deklarata L.R, FDH-6643; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, XXI, 56; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 17; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817.

Refik (Ahmet) Maxhuni

(17.03.1974, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, student)

Refiku me prindërit e vet dhe të vëllain jetonin në Gjakovë/Đakovica. Me origjinë ishte nga një familje e përzier etnikisht. Herën e fundit e kishin parë të gjallë më **4.10.1998**, në afërsi të fshatit **Novosellë/Novo Selo**. Trupi i tij është zbuluar në varrezat në fshatin Piskotë/Piskot [Gjakovë/Đakovica], ku në muajin shtator të vitit 1998 u varrosën trupat e pidentifikuara nga kanali i **Liqenit të Radoniqit/Radoničko jezero**. Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur i ka dorëzuar familjes mbetjet mortore të Refikut më 15.01.2005. Ai u varros në varrezat në Gjakovë/Đakovica.